

# Anketa për Kostot e Punës


## Viti financiar 2016

**Tiranë, më 25 Prill 2018:** INSTAT publikon rezultatet kryesore të Anketës së Kostos së Punës (AKP), duke iu referuar vitit financiar 2016. Anketa është kryer në terren në periudhën Prill-Maj 2017 dhe ndjek një periodicitet 4 vjeçar. Anketa e Kostos së Punës kryhet pranë ndërmarrjeve dhe përbën një nga burimet kryesore për matjen e niveleve dhe përbërjes së kostove të punës. Kostot e punës përfshijnë pagesat për punonjësit, pagat në kesh dhe në natyrë, kontributet për sigurimet shoqërore – pjesa e punëdhënësit, kostot e trajnimit profesional, shpenzime të tjera të kryera nga ndërmarrja si për rekrutimin e punonjësve, për veshje, strehim, si dhe shpenzime të tjera. Të dhënat për AKP 2016, në këtë publikim, i referohen ndërmarrjeve dhe institucioneve me të paktën 10 punonjës dhe mbulojnë të gjitha aktivitetet ekonomike, përveç aktiviteteve të Bujqësisë, Pyjeve, Peshkimit, Administrimit publik dhe mbrojtjes, dhe Sigurimit social të detyrueshëm.

Sipas rezultateve të Anketës për Kostot e Punës (AKP), gjatë vitit financiar 2016, në Shqipëri, kostoja mesatare orare për një njësi pune me kohë të plotë, është 351 lekë, duke u rritur me 11,8 % krahasuar me vitin 2012.


Kostoja mesatare orare për njësi pune me kohë të plotë, në ndërmarrjet me 10-49 të punësuar është 303 lekë, dhe për ndërmarrjet me mbi 1 mijë të punësuar është 438 lekë.

**Fig. 1 Kosto mesatare orare për njësi pune me kohë të plotë (në lekë)**



Sa i përket madhësisë së ndërmarrjeve, rritja më e madhe e kostos mesatare orare për njësi pune me kohë të plotë është për ndërmarrjet me të paktën 1 mijë punonjës (20,7 %), ndërsa rritja është më e vogël për ndërmarrjet me 50-249 punonjës (6,5 %).

**Fig. 2 Ndryshimi në përqindje i kostos mesatare orare për njësi pune me kohë të plotë 2012-2016**




Aktivitetet ekonomike me koston mesatare orare për njësi pune, me kohë të plotë më të lartë janë: sektori Bankar dhe ai i Sigurimeve me 700 lekë; sektori i Informacionit dhe Komunikacionit me 521 lekë; dhe sektori i Energjisë elektrike, furnizimit me gaz, avull dhe ajër të kondicionuar me 493 lekë.

Aktivitetet ekonomike me koston më të ulët mesatare orare për njësi pune me kohë të plotë janë: Akomodimi dhe aktivitetet e shërbimit të ushqimit me 241 lekë; Industria përpunuese me 250 lekë dhe Furnizimi me ujë, aktivitete të trajtimit dhe menaxhimit të mbeturinave, mbetjeve me 254 lekë.

Krahasuar me vitin 2012, gjatë vitit financiar 2016, rritja e kostos mesatare orare për njësi pune me kohë të plotë sipas aktiviteteve ekonomike ishte më e lartë për: Aktivitetet e shërbimeve administrative dhe mbështetëse, me 46,7 %; Informacioni dhe komunikacioni me 42,0 %; Shërbime të tjera (aktivitetet e shoqatave e organizatave, riparimi i kompjuterave dhe artikujve personale dhe familjarë, etj.) me 35,2 % dhe Industria nxjerrëse me 24,6 %.

Krahasuar me vitin 2012, gjatë vitit financiar 2016, rritja e kostos mesatare orare për njësi pune me kohë të plotë sipas aktiviteteve ekonomike ishte më e ulët për: aktivitetet e pasurive të paluajtëshme me 1,2 %; aktivitetet e tregtisë me shumicë dhe pakicë, me 8,9 %; aktivitetet e artit, argëtimit dhe zbavitjes, me 10 %; dhe akomodimit dhe aktivitetit të shërbimeve të ushqimit me 12,1 %.

**Fig. 3 Kosto mesatare orare për njësi pune me kohë të plotë sipas aktiviteteve ekonomike 2012 - 2016 (në lekë)**




Gjatë vitit financiar 2016, në Shqipëri, kostoja mesatare vjetore për njësi pune me kohë të plotë është 741.360 lekë (përfshirë praktikantët), ndërsa kostoja mesatare mujore për njësi pune me kohë të plotë është 61.780 lekë.

Numri mesatar vjetor i orëve të paguara të punës për një njësi pune me kohë të plotë është 2.173 orë, ndërsa, numri mesatar i orëve aktuale të punuara për njësi pune me kohë të plotë është 2.109 orë.

Në strukturën e kostove të punës për njësi pune me kohë të plotë, peshën më të madhe e zë kosto për paga dhe shpërblime e ndjekur nga kosto për kontributet e sigurimeve shoqërore (pjesa e punëdhënësit).

Fig. 4 Struktura e kostove të punës për një njësi me kohë të plotë



Në vitin 2016, pjesa që zënë shpenzimet për paga dhe shpërblime është 83,99 %, nga 82,38 % që ishte në vitin 2012. Ndërsa ka një rritje të lehtë të peshës së shpenzimeve që kryejnë ndërmarrjet për trajnimin profesional të punonjësve të tyre, nga 0,25 % në vitin 2012, në 0,42 % në vitin 2016.

Tab. 1 Struktura e përgjithshme e kostove të punës, 2012 dhe 2016

Aktiviteti ekonomik	2012	2016
Gjithsej	100,00	100,00
Pagat dhe shpërblimet	82,38	83,99
Kontributet për sigurimet shoqërore (pjesa e punëdhënësit)	15,26	14,26
Shpenzime të tjera	1,96	1,16
Taksat e punës	0,17	0,22
Kosto të trajnimit profesional	0,25	0,42

Peshën më të madhe në strukturën e të punësuarve me pagë e zë sektori i industrisë përpunuese, me 20,5 %, pasuar nga aktivitetet e arsimit me 13,8 % dhe i tregtisë me 10,9 %.

Të punësuarit me pagë me kohë të plotë përbëjnë 98,4 % të të punësuarve dhe të punësuarit me kohë të pjesshme 1,6 %. Përqindja e praktikantëve e raportuar nga ndërmarrjet në studim është 0,4 %.

**Tab. 2 Struktura e të punësuarve me pagë sipas aktivitetit ekonomik (%)**

Seksioni NVE Rev 2	Aktiviteti ekonomik	Njësi pune me kohë të plotë	Të punësuar me pagë
<b>B-S</b>	<b>Gjithsej</b>	100,0	100,0
<b>B</b>	Industria nxjerrëse	2,6	2,6
<b>C</b>	Industria përpunuese	20,5	20,5
<b>D</b>	Energjia Elektrike, furnizimi me gaz, avull dhe ajër i kondicionuar	2,5	2,5
<b>E</b>	Aktivitetet me ujë të ngrohtë, kanalizimeve, menaxhimit të mbeturinave dhe rregullimit	2,8	2,8
<b>F</b>	Ndërtimi	9,6	9,6
<b>G</b>	Tregtia me shumicë dhe pakicë; Riparimi i automobilitave e motoçikletave	11,0	10,9
<b>H</b>	Transport dhe magazinim	2,8	2,8
<b>I</b>	Akomodimi dhe aktivitetet e shërbimit të ushqimit	3,6	3,6
<b>J</b>	Informacioni dhe Komunikacioni	3,6	3,6
<b>K</b>	Aktivitetet financiare dhe Sigurimit	2,9	2,9
<b>L</b>	Pasuritë e patundshme	0,3	0,3
<b>M</b>	Aktivitetet profesionale, Shkencore dhe teknike	2,2	2,2
<b>N</b>	Aktivitetet administrative dhe Shërbimet mbështetëse	9,6	9,7
<b>P</b>	Arsimi	13,7	13,8
<b>Q</b>	Shëndetësia dhe veprimtari të tjera sociale	8,1	8,1
<b>R</b>	Art, Argëtim dhe zbavitje	2,6	2,6
<b>S</b>	Aktivitete të tjera shërbimi	1,5	1,5

**Tab. 3 Orët reale mesatare vjetore të punës dhe orët mesatare vjetore të paguara, për njësi pune me kohë të plotë, sipas aktivitetit ekonomik**

Seksioni NVE Rev 2	Aktiviteti ekonomik	Orët mesatare reale	Orët mesatare të paguara
<b>B-S</b>	<b>Gjithsej</b>	<b>2.109</b>	<b>2.173</b>
<b>B</b>	Industri nxjerrëse	2.164	2.231
<b>C</b>	Industri përpunuese	2.158	2.222
<b>D</b>	Furnizimi me Energji Elektrike, Gaz e Avull dhe me Ajër të Kondicionuar	2.130	2.194
<b>E</b>	Aktivitetet me ujë të ngrohtë, kanalizimeve, menaxhimit të mbeturinave dhe rregullimit	2.143	2.209
<b>F</b>	Ndërtimi	2.138	2.204
<b>G</b>	Tregtia me shumicë dhe pakicë; Riparimi i automobilitave e motoçikletave	2.149	2.215
<b>H</b>	Transport dhe magazinim	2.094	2.158
<b>I</b>	Akomodimi dhe aktivitetet e shërbimit të ushqimit	2.065	2.130
<b>J</b>	Informacioni dhe Komunikacioni	2.100	2.165
<b>K</b>	Aktivitetet financiare dhe Sigurimit	2.139	2.192
<b>L</b>	Pasuritë e patundshme	2.180	2.247
<b>M</b>	Aktivitetet profesionale, Shkencore dhe teknike	2.107	2.172
<b>N</b>	Aktivitetet administrative dhe Shërbimet mbështetëse	1.953	2.015
<b>P</b>	Arsimi	2.086	2.150
<b>Q</b>	Shëndetësia dhe veprimtari të tjera sociale	2.113	2.174
<b>R</b>	Art, Argëtim dhe zbavitje	2.091	2.156
<b>S</b>	Aktivitete të tjera shërbimi	2.087	2.151

**Tab. 4 Kostoja mesatare e punës për njësi pune me kohë të plotë sipas aktiviteteve ekonomike, në lekë**

Seksioni NVE Rev 2	Aktiviteti ekonomik	Kosto orare	Kosto mujore	Kosto vjetore
<b>B-S</b>	<b>Gjithsej</b>	<b>351</b>	<b>61.780</b>	<b>741.360</b>
<b>B</b>	Industri nxjerrëse	440	79.349	952.186
<b>C</b>	Industri përpunuese	250	44.923	539.072
<b>D</b>	Furnizimi me Energji Elektrike, Gaz e Avull dhe me Ajër të Kondicionuar	493	87.435	1.049.219
<b>E</b>	Aktivitetet me ujë të ngrohtë, kanalizimeve, menaxhimit të mbeturinave dhe rregullimit	254	45.377	544.526
<b>F</b>	Ndërtimi	327	58.309	699.707
<b>G</b>	Tregtia me shumicë dhe pakicë; Riparimi i automobilitave e motoçikletave	281	50.374	604.492
<b>H</b>	Transport dhe magazinim	435	75.919	911.025
<b>I</b>	Akomodimi dhe aktivitetet e shërbimit të ushqimit	241	41.489	497.868
<b>J</b>	Informacioni dhe Komunikacioni	521	91.178	1.094.132
<b>K</b>	Aktivitetet financiare dhe Sigurimit	700	124.824	1.497.890
<b>L</b>	Pasuritë e patundshme	343	62.286	747.436
<b>M</b>	Aktivitetet profesionale, Shkencore dhe teknike	481	84.510	1.014.122
<b>N</b>	Aktivitetet administrative dhe Shërbimet mbështetëse	336	54.756	657.075
<b>P</b>	Arsimi	416	72.268	867.214
<b>Q</b>	Shëndetësia dhe veprimtari të tjera sociale	388	68.273	819.275
<b>R</b>	Art, Argëtim dhe zbavitje	353	61.499	737.985
<b>S</b>	Aktivitetet të tjera shërbimi	388	67.445	809.342

**Tab. 5 Struktura e kostos së punës sipas aktivitetit ekonomik**

Seksioni NVE Rev 2	Aktiviteti ekonomik	Kostoja e punës gjithsej	prej të cilës					
			Kompensimi i të punësuarve me pagë		Kosto të trajnimit profesional	Shpenzime të tjera (rekrutim, veshje mbrojtëse etj)	Taksat e punës	Subvencionet e marra nga ndërmarrjet
			Pagat dhe shpërblymimet	Kontributet e sigurimeve (pjesa e punëdhënësit)	në përqindje			
<b>B-S</b>	<b>Gjithsej</b>	<b>100</b>	<b>83,99</b>	<b>14,26</b>	<b>0,42</b>	<b>1,16</b>	<b>0,22</b>	<b>-0,06</b>
<b>B</b>	Industri nxjerrëse	100	84,26	14,1	0,21	1,4	0,02	0,00
<b>C</b>	Industri përpunuese	100	83,29	13,97	0,74	1,04	1,13	-0,15
<b>D</b>	Furnizimi me Energji Elektrike, Gaz e Avull dhe me Ajër të Kondicionuar	100	85,79	14,17	0,01	0,03	0,00	0,00
<b>E</b>	Aktivitetet me ujë të ngrohtë, kanalizimeve, menaxhimit të mbeturinave dhe rregullimit	100	83,7	14,23	0,18	1,82	0,14	-0,07
<b>F</b>	Ndërtimi	100	84,73	14,47	0,07	0,59	0,16	-0,02
<b>G</b>	Tregtia me shumicë dhe pakicë; Riparimi i automobilitave e motoçikletave	100	84,29	14,37	0,38	0,93	0,03	0,00
<b>H</b>	Transport dhe magazinim	100	81,88	13,79	0,02	4,35	0,06	-0,11
<b>I</b>	Akomodimi dhe aktivitetet e shërbimit të ushqimit	100	82,76	14,74	0,22	1,99	0,29	0,00
<b>J</b>	Informacioni dhe Komunikacioni	100	84,15	14,25	1,4	0,14	0,06	0,00
<b>K</b>	Aktivitetet financiare dhe Sigurimit	100	84,55	13,82	1,45	0,13	0,05	0,00
<b>L</b>	Pasuritë e patundshme	100	83,78	14,4	0,05	1,78	0,00	0,00
<b>M</b>	Aktivitetet profesionale, Shkencore dhe teknike	100	84,78	14,43	0,27	0,49	0,03	0,00
<b>N</b>	Aktivitetet administrative dhe Shërbimet mbështetëse	100	81,56	13,51	0,63	4,19	0,11	0,00
<b>P</b>	Arsimi	100	85,07	14,68	0,05	0,26	0,00	-0,06
<b>Q</b>	Shëndetësia dhe veprimtari të tjera sociale	100	83,68	14,76	0,21	1,49	0,04	-0,19
<b>R</b>	Art, Argëtim dhe zbavitje	100	84,99	14,24	0,01	0,74	0,02	0,00
<b>S</b>	Aktivitetet të tjera shërbimi	100	85,35	14,58	0,11	0,06	0,03	-0,14

# Metodologjia

**Anketa për Kostot e Punës** kryhet pranë ndërmarrjeve me 10 të punësuar e më shumë.

Baza e zgjedhjes së ndërmarrjeve për anketën e Kostove të Punës është Rregjistri Statistikor i Ndërmarrjeve Ekonomike 2016. Njësitë statistikore të vrojtura janë ndërmarrjet ekonomike me 10 të punësuar e më shumë për seksionet e NVE Rev 2 nga B deri tek S (pa përfshirë seksionin O – Administrimi publik dhe i mbrojtjes; Sigurimi shoqëror i detyruar).

Zgjedhja e ndërmarrjeve u bë me metodën e zgjedhjes sistematike të rastit ku shtresëzimi u bazua në aktivitetin ekonomik të ndërmarrjes sipas Nomenklaturës së Veprimtarive Ekonomike Rev2 në nivel dyshifror, dhe në madhësinë e ndërmarrjes. Ndërmarrjet me 50 të punësuar e më shumë janë përfshirë të gjitha në anketë. Madhësia e zgjedhjes për anketën e kostove të punës është 2.980 ndërmarrje jobujqësore.

**Periudha Referuese:** Të dhënat e Anketës për Kostot e Punës i referohen vitit financiar 2016.

**Kostot e punës,** i referohen shpenzimeve totale që kryejnë punëdhënësit për stafin e punësuar. Ato përfshijnë kompensimin për të punësuarit. i cili përbëhet kryesisht nga pagat bruto në kesh ose në natyrë dhe kontributet e sigurimeve shoqërore që paguan punëdhënësi, kostot e trajnimit profesional, shpenzime të tjera si kostot e rekrutimit dhe shpenzimet për veshje pune, taksat e punësimit nga të cilat zbriten subvencionet e marra.

**Kostot mesatare orare të punës,** janë kostot vjetore të punës pjesëtuar me numrin e orëve punuar gjatë vitit të referencës.

**Kostot e punës në muaj për të punësuar kundrejt pagesës,** janë kostot vjetore të punës të pjesëtuar me 12 dhe me numrin mesatar të të punësuarve kundrejt pagesës gjatë vitit të referencës (konvertuar në ekuivalente të kohës së plotë).

**Të Punësuarit me Pagë,** janë të gjithë personat që punojnë direkt me ndërmarrjen dhe marrin pagesë nga punëdhënësi.

**Praktikantët,** janë të punësuarit me pagë që akoma nuk marrin pjesë tërësisht në procesin e prodhimit dhe që punojnë ose nën një kontratë stazhi ose në një situatë në të cilën trajnimi profesional predominon kundrejt produktivitetit.

**Numri mesatar i orëve në javë të punuara zakonisht,** janë orët e punuara zakonisht ose orët e kontraktuara për një të punësuar me pagë të kategorive që vijojnë: një i punësuar me pagë me kohë të plotë, një i punësuar me pagë me kohë të pjesshme, një praktikant.

**Pagat për të punësuarit me pagë me kohë të plotë dhe të pjesshme** përfshijnë shpërblimet, pagesën për copë dhe punën me turne, shtesat/dietat, honorarët, bakshishet, komisionet dhe pagesat në natyrë.

**Pagesat direkte, shpërblimet dhe shtesat** përfshijnë vlerat e çdo kontributi social, taksave mbi të ardhurat, etj. të pagueshme nga i punësuarit me pagë edhe në se ato faktikisht mbahen nga punëdhënësi dhe paguhet direkt në skemat e sigurimeve shoqërore, tatim-taksat, etj, në emër të të punësuarit me pagë.

**Kompensimi** paguhet për lejen e dhënë ligjore, të kontraktuar ose vullnetare dhe për festat publike apo ditë të tjera të paguara kur nuk punohet.

**Kontributet e punëdhënësit për sigurimet shoqërore (përfshirë praktikantët)**, janë kontributet shoqërore të dhëna nga punëdhënësit në mënyrë që të sigurojnë për punonjësit e tyre (me kohë të plotë dhe të pjesshme) të drejtën për përfitime sociale.

**Kostot e trajnimit profesional të paguara nga punëdhënësi**, janë shpenzimet për shërbimet dhe lehtësirat për trajnimet profesionale.

**Taksat e punës (Jo taksat mbi të ardhurat)**, ky variabël mbulon të gjitha taksat në bazë të faturës së pagave dhe rrogave, ose në punësim. Këto taksa janë konsideruar si kosto pune. Gjithashtu mbulon taksat ndëshkimore të paguara nga punëdhënësit për punësimin e shumë pak personave me aftësi të kufizuar, si dhe taksa të tjera të ngjashme.

**Subvencionet e marra nga punëdhënësi**, janë të gjitha shumat e marra në formën e subvencioneve të një natyre të përgjithshme nga ana e punëdhënësit me qëllim që të kthehen një pjesë ose të gjitha si kosto e shpërblimit të drejtpërdrejtë të punonjësve. por nuk ka për qëllim për të mbuluar shpenzimet për sigurimet shoqërore ose trajnimet profesionale.



# Cilësia e statistikave të Kostove të Punës

Të dhënat e anketës janë përgjithësuar për të gjithë popullatën në studim (ndërmarrjet jo-bujqësore me 10 të punësuar e më shumë). Procesi i përgjithësimit të të dhënave merr parasysh probabilitetin e zgjedhjes së ndërmarrjeve dhe gjithashtu kompenson për ndërmarrjet të cilat janë:

- pa kontakt;
- të mbyllura;
- të fjetura;
- refuzuan që të marrin pjesë në anketë.

Të dhënat e Anketës së Kostos së Punës u mblodhën në dy mënyra:

- Me anketues të cilët plotësuan pyetësonin e printuar.
- Me dërgimin me e-mail nga ana e ndërmarrjes të pyetësonit të plotësuar.

[www.instat.gov.al/al/rreth-nesh/aktivitetet/anketa-dhe-studime/anketa-per-koston-e-punes-ne-shqipëri-2016/](http://www.instat.gov.al/al/rreth-nesh/aktivitetet/anketa-dhe-studime/anketa-per-koston-e-punes-ne-shqipëri-2016/)

Nga ndërmarrjet e zgjedhura 8,3 % nuk e plotësuan anketën për arsye se ishin mbyllur, fjetur ose refuzuan të përgjigjen. 3,7 % të këtyre ndërmarrjeve u imputuan nga të dhënat administrative. Shkalla neto e pjesëmarrjes së ndërmarrjeve jo-bujqësore me 10 të punësuar e më shumë në Anketën e Kostove të Punës është 95,4 %.

Për çdo tregues në vërtetim është llogaritur varianca. Llogaritja e variancës për koston totale vjetore të punës dhe e koston mesatare orare për njësi pune me kohë të plotë është bërë në SAS-software duke përdorur makro CLAN. Në tabelat e mëposhtme pasqyrohen devijimet standarde dhe koeficientet e variacionit të dy variablave kryesore të vërtetimit, koston vjetore dhe koston për orë të punës.

**Tab. 6 Koeficientët e variacionit për koston totale vjetore të punës sipas seksioneve të NVE Rev2**

Seksioni	Aktiviteti ekonomik	Kosto Totale vjetore e punës (në lekë)	Devijimi Standard	Koeficienti i variacionit (%)
		$\hat{t}$	$\sqrt{V(\hat{t})}$	$CV(\hat{t})$
<b>B-S</b>	<b>Gjithsej</b>	<b>260.015.776.586</b>	<b>1.521.165.787</b>	<b>0,59</b>
<b>B</b>	Industria nxjerrëse	8.702.979.572	153.278.639	1,76
<b>C</b>	Industria përpunuese	38.846.074.666	624.130.224	1,61
<b>D</b>	Energjia elektrike, gazi, Avulli dhe Furnizimi me ajër të kondicionuar	9.098.824.005	361.990.948	3,98
<b>E</b>	Furnizimi me ujë. Aktivitetet e trajtimit dhe menaxhimit të mbeturinave, mbetjeve	5.387.539.891	88.150.759	1,64
<b>F</b>	Ndërtimi	23.588.516.064	866.945.858	3,68
<b>G</b>	Tregtia me shumicë dhe me pakicë. Riparimi i automjeteve dhe motoçikletave	23.283.806.787	720.304.080	3,09
<b>H</b>	Transporti dhe magazinimi	8.970.864.811	223.874.863	2,50
<b>I</b>	Akomodimi dhe shërbimi ushqimor	6.295.041.143	259.612.867	4,12
<b>J</b>	Informacioni dhe Komunikacion	13.719.319.313	221.308.178	1,61
<b>K</b>	Aktivitetet financiare dhe Sigurimit	15.251.513.106	22.902.000	0,15
<b>L</b>	Pasuritë e patundshme	723.517.659	21.463.424	2,97
<b>M</b>	Aktivitete profesionale, Shkencore dhe Teknike	7.910.148.341	224.242.544	2,83
<b>N</b>	Shërbime administrative dhe mbështetëse	22.176.933.514	312.739.343	1,41
<b>P</b>	Arsimi	41.764.164.204	344.199.231	0,82
<b>Q</b>	Shëndetësia	23.260.047.028	377.414.145	1,62
<b>R</b>	Arte, Argëtim dhe Çlodhje	6.802.011.188	60.560.879	0,89
<b>S</b>	Aktivitete të tjera shërbimi	4.234.475.294	189.970.935	4,49

**Tab 7 Koefficientët e variacionit për koston mesatare orare për njësi pune me kohë të plotë sipas seksioneve të NVE Rev2**

Seksioni	Aktiviteti ekonomik	Kosto mesatare orare (në lekë)	Devijimi Standard	Koefficienti i variacionit (%)
		$\hat{t}$	$\sqrt{V(\hat{t})}$	$CV(\hat{t})$
<b>B-S</b>	<b>Gjithsej</b>	<b>351</b>	<b>1,6</b>	<b>0,45</b>
<b>B</b>	Industria nxjerrëse	440	6,2	1,40
<b>C</b>	Industria përpunuese	250	3,4	1,37
<b>D</b>	Energjia elektrike, gazi, Avulli dhe Furnizimi me ajër të kondicionuar	493	19,4	3,93
<b>E</b>	Furnizimi me ujë, Aktivitetet e trajtimit dhe menaxhimit të mbeturinave, mbejjeve	254	1,6	0,62
<b>F</b>	Ndërtimi	327	6,8	2,09
<b>G</b>	Tregtia me shumicë dhe me pakicë, Riparimi i automjeteve dhe motocikletave	281	6,6	2,33
<b>H</b>	Transporti dhe magazinimi	435	9,6	2,20
<b>I</b>	Akomodimi dhe shërbimi ushqimor	241	3,6	1,47
<b>J</b>	Informacioni dhe Komunikacion	521	9,0	1,73
<b>K</b>	Aktivitetet financiare dhe Sigurimit	700	1,3	0,18
<b>L</b>	Pasuritë e patundshme	343	3,9	1,15
<b>M</b>	Aktivitete profesionale, Shkencore dhe Teknike	481	10,0	2,08
<b>N</b>	Shërbime administrative dhe mbështetëse	336	3,1	0,92
<b>P</b>	Arsimi	416	1,9	0,46
<b>Q</b>	Shëndetësia	388	2,9	0,75
<b>R</b>	Arte, Argëtim dhe Çlodhje	353	1,7	0,49
<b>S</b>	Aktivitete të tjera shërbimi	388	13,8	3,57